



Kuvendi i Komunës Klinë

Nr prot. 06-1836/2024

Datë: 05.06 /2024

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 pika d) si dhe nenit 40.paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17, 38, 60 dhe 61 Ligjit për Financa Publike dhe Përgjegjësit nr 05/L-1007 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-048 nenit 7 dhe 8 të Rregullorës Komunale Për Ndarje të Subvencione dhe Transfereve Nr 06-4043/2015 , nenit 16 paragrafi 8 pika 8.2 të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, nenit 92 të Statutit të Komunës, me kërkesën e drejtoris për Financa Ekonomi dhe Zhvillim si dhe me rekomandimin e KPF-së, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë: 30.05.2024.mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për shtim të buxhetit për projektin " **Furnizim me mekanizma bujqësor Lot.1 Multikutivator**" në shumë prej: 15,750.00 euro- Kategoria Ekonomike Subvencione dhe Transfere.
2. Projekti" **Furnizim me mekanizma bujqësor Lot.1 Multikutivator**" 30% mbulohet nga mjetet e participimit nga qytetarët kurse pjesa tjetër 70% do të mbulohet nga Komuna, kategoria ekonomike **Subvencione dhe transfere**, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kodi i programit (47018)
3. Komuna financo me mjete financiare në shumë prej **36,750.00** euro nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kodi programit (47018) kurse qytetarët kanë participuar me mjete në vlerë prej **15,750.00** euro, vlera e tërësishme e projektit është **52,500.00** euro.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.
6. Më këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës.



**Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi**